

V E N D I M
Nr.546, datë 1.8.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.675, DATË 20.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE, TË PLANIFIKUARA PËR MALLRAT, SHËRBIMET DHE NDËRTIMET”, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.146, DATË 7.3.2003

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1.2 ndryshon si më poshtë vijon:

“1.2 Vendimi të zbatohet nga të gjitha entet prokuruese, që kanë fonde buxhetore të planifikuara për mallra, shërbime dhe ndërtime dhe nga organet e qeverisjes vendore, për fondet që jepen nga Buxheti i Shtetit për këtë qëllim.”.

2. Pika 1.3 të shfuqizohet.

3. Në pikën 2.1 fjala “... institucionet ...” zëvendësohet me “... entet prokuruese ...”.

4. Pika 2.2 ndryshon si më poshtë vijon:

“2.2 Një kopje e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, i miratuar nga drejtuesi i entit prokurues, i dërgohet brenda datës 20 janar të çdo viti, institucionit që vë në dispozicion fondet. Institucionet që vënë në dispozicion fondet, brenda datës 30 janar të çdo viti, dërgojnë në Agjencinë e Prokurimit Publik, në Drejtorinë e Thesarit dhe të Buxhetit në Ministrinë e Financave, përmbledhjen e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike të tyre dhe të enteve të varësisë. Drejtoria e Thesarit dhe e Buxhetit u dërgon nga një kopje degëve të thesarit në rrethe.”.

5. Pika 2.3 ndryshon si më poshtë vijon:

“2.3 Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të të dhënave të regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike, të dërguara nga institucionet qendrore, përgatit regjistrin qendror të parashikimeve të prokurimeve publike dhe e shpall atë në “Buletin e Prokurimit Publik”, brenda datës 15 shkurt të çdo viti.”.

6. Pika 2.4 shfuqizohet.

7. Emërtimi i kapitullit III ndryshon dhe bëhet “Prokurimi i mallrave, shërbimeve dhe ndërtimeve”.

8. Pika 3.2 ndryshon si më poshtë vijon:

“3.2 Procedurat e prokurimit për fonde të krijuara ose të shtuara pas miratimit të Buxhetit të Shtetit, nisin menjëherë pas vënies në dispozicion të këtyre fondeve. Në këtë rast, institucionet qendrore njoftojnë Drejtorinë e Thesarit dhe të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Agjencinë e Prokurimit Publik, të cilat bëjnë ndryshimet në regjistrat përkatës”.

9. Pika 3.3 ndryshon si më poshtë vijon:

“3.3 Procedurat e prokurimit për fonde të planifikuara për ndërtime, të cilat nuk kanë projekte të miratuara, nisin menjëherë, pas përfundimit të projektit.”.

10. Pika 4.3 ndryshon si më poshtë vijon:

“4.3 Kontratat pas kryerjes së procedurave të prokurimit, të përcaktuara në pikat 6.1 dhe 6.2 të këtij vendimi, lidhen nga institucioni, në emër të të cilit është zhvilluar prokurimi, për fondin e vënë në dispozicion dhe sipas nevojave të parashikuara.”.

11. Në pikën 5.1 fjalët “... organet dhe institucionet buxhetore ...” zëvendësohen me “... entet prokuruese ...”. Pas fjalës “... prokurimeve ...” shtohet fjala “... publike...”.

12. Pika 5.2 ndryshon si më poshtë vijon:

“5.2 Një kopje e regjistrit të realizimeve të prokurimeve publike, i miratuar nga drejtuesi i entit prokurues, i dërgohet brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të këtij vendimi, institucionit që vë në dispozicion fondet. Këto institucione dërgojnë në Agjencinë e

Prokurimit Publik, brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të këtij vendimi, përmbledhjen e regjistrave të realizimeve të prokurimeve publike të tyre dhe të enteve të varësisë.”.

13. Pika 5.3 ndryshon si më poshtë vijon:

“5.3 Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të të dhënave të regjistrave të realizimeve të prokurimeve publike, të dërguara nga institucionet qendrore dhe vendore, përgatit regjistrin qendror të realizimeve të prokurimeve publike dhe e shpall atë në “Buletinin e Prokurimit Publik”, brenda datës 31 korrik të çdo viti.”.

14. Pika 6.1 ndryshon si më poshtë vijon:

“6.1 Institucionet qendrore, brenda datës 10 janar të çdo viti, përcaktojnë listat e mallrave, të ndërtimeve ose të shërbimeve të njëjta të parashikuara nga entet e varësisë, për të cilat procedurat e prokurimit do të kryhen nga institucioni qendror ose nga institucioni i autorizuar prej tij. Ky ent prokuron me fondin e llogaritur si shumë e fondeve të miratuara, për çdo ent varësie, për të njëjtin mall, shërbim ose ndërtim.

Për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet e tjera prokurimi të kryhet nga çdo ent prokurues i varësisë, në përputhje me procedurat e ligjit “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të fondeve përkatëse në dispozicion.”.

15. Në paragrafin e parë të pikës 6.2 fjalët “... mallrat dhe shërbimet ...” zëvendësohen me “... mallrat, ndërtimet dhe shërbimet ...”.

16. Në paragrafin e katërt të pikës 6.2 hiqen fjalët “... telefoni celulare ...”.

17. Në paragrafin e gjashtë të pikës 6.2 fjalët “... autovetura të tjera...” zëvendësohen me “... autovetura të reja ...”.

18. Pika 6.3 ndryshon si më poshtë vijon:

“6.3 Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e pikës 6.2 të këtij vendimi, u dërgon institucioneve, enteve prokuruese, të ngarkuara për prokurimin e fondeve për llogari të të tretëve, të dhënat e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike.”.

19. Në pikën 6.4 fjalët “... 15 shkurt ...” zëvendësohen me “... 31 janar ...”.

20. Pika 7.1 ndryshon si më poshtë vijon:

“7.1 Afati i përcaktuar në pikën 3.1 të këtij vendimi për vitin 2003 shtyhet deri në datën 30 tetor, duke përfshirë edhe të gjitha procedurat e prokurimit, të zhvilluara pas datës 15 qershor 2003.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano